

**URDHËR**  
**Nr. 183, datë 17.6.2020**

**PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE TË OPERIMIT TË MJETEVE LUNDRUESE,**  
**PËR QËLLIME TURISTIKE DHE ARGËTIMI, NË PORTET DETARE DHE NË**  
**RADA**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 32, pika 2, shkronja “s” dhe 401, pika “b”, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 504, datë 13.9.2017, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, me qëllim rregullimin e aktivitetit të mjeteve lundruese të kënaqësisë në portet detare të Republikës së Shqipërisë dhe në radat e tyre përkatëse gjatë sezonit turistik,

**URDHËROJ:**

1. Ky urdhër është i zbatueshëm për mjetet lundruese, për qëllime turistike dhe argëtimi, të cilat lejohen që të operojnë në portet detare të Republikës së Shqipërisë, rada, si dhe vendet e përgatitura posaçërisht për akostimin e tyre.

2. Agjencia detare lajmëron paraprakisht kapitenarinë e portit, portin detar, si dhe Policinë e Shtetit, për formalitetet e mbërritjes së mjetit lundrues, që kërkon të operojë në portin detar për qëllime turizmi dhe argëtimi.

3. Lajmërimi duhet të përcaktojë arsyet e operimit në port, shërbimin që do të kryejë, kohën e qëndrimit, personat në bord, si dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga kapitenaria e portit apo porti detar.

4. Në rastet kur mjeti lundrues kërkon të qëndrojë përkohësisht për furnizime bordi, kapitenaria e portit përkatës lejon akostimin e mjetit lundrues, vetëm pasi agjencia detare që përfaqëson mjetin turistik të ketë paraqitur pranë kapitenarisë miratimin e autoritetit portual për kalatën ku do të akostohet mjeti.

5. Pavarësisht miratimit nga autoriteti portual dhe kapitaneria e portit, mjeti lundrues nuk do të bëhet pengesë për përpunimin e mjeteve të tjera lundruese. Në çdo rast, këto mjete duhet të jenë në gatishmëri të lirojnë menjëherë kalatat pas njoftimit nga kapitaneria.

6. Mjetet turistike do të lejohen të qëndrojnë në radat e portit pa kufizim, duke zbatuar të gjitha rekomandimet e dhëna nga kapitaneria e portit përkatës.

7. Personat që do të vizitojnë vendin tonë me mjete për qëllime turistike dhe argëtimi zbatojnë gjithë legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

8. Detyrimin për përmbushjen e kushteve të sipërme e kanë si subjektet që zotërojnë mjetet lundruese dhe agjencitë detare që i përfaqësojnë ato.

9. Mosplotësimi i detyrimeve do të ndëshkohet me masa administrative, në zbatim të legjislacionit shqiptar në fuqi.

10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Detare dhe portet detare për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**  
**Belinda Balluku**